



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:077157

Datë: 30.03.2024

Numri i dokumentit: 05528864

C.nr.269/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditëses K. me seli në Prishtinë, Distrikti në Gjakovë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.M, e paraqitur kundër të paditurit M.M nga fshati Radostë, Komuna e Rahovecit, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit, vlera e objektit të kontestit 140.74 euro, pas seancës së mbajtur më datën 28.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia e paditëses K. me seli në Prishtinë, Distrikti në Gjakovë, ndaj të paditurit M.M nga fshati Radostë, Komuna e Rahovecit, në çështjen juridike kontestimore, C.nr.269/2021.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja K. me seli në Prishtinë, Distrikti në Gjakovë, në këtë gjykatë më datën 13.04.2021, ka parashtruar padinë kundër të paditurit M.M nga fshati Radostë, Komuna e Rahovecit, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit, vlera e objektit të kontestit 140.74 euro.

Në seancën përgatitore të datës 18.03.2024 paditësja është tërhequr nga padia, ndërsa i padituri ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë së paditëses.

Meqenëse edhe e paditura ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë, kjo gjykatë vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për konstatimin e tërheqjes së padisë së palës paditëse në këtë çështje kontestimore. Kështu, në nenin 261.2 të LPK-së, sipas të cilit *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t’i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së pasi që secila palë paraprakisht vet i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.

Numri i lëndës: 2021:077157  
Datë: 30.03.2024  
Numri i dokumentit: 05528864

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 261.2, 261.3 dhe 261.4 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.269/2021, më datën 28.03.2024

Gjyqtari  
Berkan Hamza

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.